 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 1 nga 18


Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit

Zbatues: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë, Drejtoria e Akreditimit të organeve certifikuese dhe inspektuese, Drejtoria e Zhvillimit, Sekretariati, kryevlerësuesit vlerësuesit dhe ekspertët teknik.

Përgjegjës për zbatimin: Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë, Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese dhe inspektuese.

Kontrolluar nga: Menaxhere cilësie
Ardita MELE

Miratuar nga: Drejtor i Përgjithshëm
Pranvera FAGU

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit</p>	<p>Kodi DA – PT - 006</p>
		<p>Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023</p>
		<p>Faqe 2 nga 18</p>

1. QËLLIMI

Kjo proçedurë specifikon në detaje kushtet e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit dhe veprimet që duhet merren në raste të tilla.

2. FUSHA E ZBATIMIT


Kjo proçedurë zbatohet në të gjitha rastet e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të statusit “I akredituar” të Organeve të Vlerësimit të Konformitetit kur kërkohet nga DPA, apo me kërkesë të vetë organit të akredituar.

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo proçedurë zbatohet nga stafi i Drejtoria e Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë, Drejtoria e Akreditimit të organeve certifikuese dhe inspektuese, Drejtoria e Zhvillimit, Sekretariati, Drejtori i Përgjithshëm , vlerësuesit dhe kryevlerësuesit . Përgjegjës për kontrollin e zbatimit të kësaj proçedure është Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë, Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese dhe inspektuese.

4. REFERIMET

- Standardi S SH EN ISO/IEC 17011:2017 “Kërkësa të përgjithshme për organizmat e akreditimit të cilat kryejnë akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit”, Paragrafi 7.10; 7.11.
- Ligji Nr. 116, datë 11. 09.2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.
- IAF MD 7:2023 Harmonizimi i Sanksioneve dhe ndjekja e sjelljeve mashtruese”
- IAF MD 2:2007 IAF Mandatory Document for the Transfer of Accredited Certification of Management Systems.
- Procedura e akreditimit, mbikqyrjes dhe rinovimit DA-PT-001
- Procedura e vizitës vlerësuese DA-PT-002
- Procedura e apelimeve dhe ankesave DA-PM-005
- Forma e raportimit të vlerësimit per labororet DA-FO-001
- Forma e planit të vlerësimit DA-FO-002
- Forma e paraqitjes së moskonformiteteve DA-FO-003

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit</p>	<p>Kodi DA – PT - 006</p>
		<p>Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023</p>
		<p>Faqe 3 nga 18</p>

- | | |
|--|-----------|
| - Forma e paraqitjes së veprimeve korigjuese | DA-FO-011 |
| - Forma e raportit të vlerësimit të trupave certifikues të personelit | DA-FO-013 |
| - Forma e raportit të vlerësimit të trupave certifikues të produktit | DA-FO-049 |
| - Forma e raportit të vlerësimit të trupave certifikues të sistemeve te menaxhimit | DA-FO-004 |
| - Forma e raportimit të vlerësimit të trupave inspektues | DA-FO-048 |
| - Forma e rregjistrimit të apelimeve dhe ankesave | DA-FO-024 |

5. FJALORI DHE SHKURTIME

Për qëllimet e këtij dokumenti janë përdorur termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin S SH EN ISO/IEC 17011:2017 dhe S SH EN ISO 9000:2015, si dhe ato të dhëna në Manualin e Cilësisë të DPA.

6. PEZULLIM I AKREDITIMIT


Pezullimi i akreditimit nënkupton se DPA vendos kufizimin e përkohshëm të statusit të akreditimit për plotësisht ose të pjesshme të fushës së akreditimit. Statusi i akreditimit mund të pezullohet me kërkesë vullnetare nga OVK-ja e akredituar ose në bazë të kërkesës së DPA, kur një apo më shumë nga kushtet e përcaktuara në pikën 6.3 janë plotësuar. Pezullimi i akreditimit vendoset vetëm për një pjesë të fushës së akreditimit kur kushtet e përmendura në pikën 6.3 të kësaj procedure janë plotësuar për një pjesë të fushës së akreditimit. Në të dyja rastet, pezullimi vullnetar ose pezullimi i kërkuar nga DPA, zbatohet procedura e mëposhtme.

6.1 PEZULLIM I KËRKUAR NGA OVK

OVK e akredituar i paraqet DPA-së një kërkesë me shkrim për pezullimin e akreditimit.

Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese, ose komiteti teknik përkatës në rast të organeve të lidhura, pas vlerësimit të kërkesës, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm një periudhë pezullimi. Drejtori i Përgjithshëm merr vendim për pezullim. Periudha për vetë-pezullimin nuk mund të jetë më e gjatë se 6 muaj. Pas kësaj, akreditimi tërhiqet siç përshkruhet në pikën 7 të kësaj procedure.

Departamenti i Zhvillimit përditëson listën e organeve të akredituara në faqen e internetit të DPA duke e vendosur OVK me vizë në mes dhe fusha e pezulluar nuk shfaqet.

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit</p>	<p>Kodi DA – PT - 006</p>
		<p>Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023</p>
		<p>Faqe 4 nga 18</p>

6.2 PEZULLIM I KËRKUAR NGA DPA

Kur plotësohet një ose më shumë nga kushtet për pezullim të renditura në pikën 6.3 të kësaj procedure, në afat prej 10 ditësh, Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibruës dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese ose komiteti teknik përkatës në rast të organeve të lidhura, ose Shefi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve, dorëzon një rekomandimin për pezullim tek Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtori i Përgjithshëm mund të kërkojë më shumë informacion rreth rekomandimit të pezullimit. Brenda 15 ditësh pas marrjes së të gjithë informacionit, Drejtori i Përgjithshëm merr vendim për pezullimin. Ai i njofton OVK për vendimin mbi pezullimin duke përfshirë një shpjegim të qartë të arsyeve të pezullimit.

Organi ka të drejte të apelojë brenda 10 diteve pas marrjes së vendimit.

Ankesa trajtohet konform procedurës DA-PM-005. Megjithatë, nisja e një ankimimi nuk çon në pezullimin e vendimit të DPA, mbi akreditimin.


Nëse OVK nuk fillon ndonjë ankesë brenda periudhës së caktuar, DPA:

- Përgatit faturën për tarifën e procedurës së vlerësimit që duhet të paguhet nga organi i akredituar brenda afatit të përcaktuar nga DPA.
- Sigurimi i pagesës së vlerësuesve.
- Publikon pezullimin e akreditimit ne faqen e internetit të DPA duke e vendosur OVK me vizë në mes dhe fusha e pezulluar nuk shfaqet.

6.3 KUSHTET PËR PEZULLIMIN E AKREDITIMIT

Kushtet mbi të cilat vendos DPA për pezullimin e akreditimit janë si në vijim:

- a. Ka gjetje kundër veprimtarisë së OVK të akredituar, duke përfshirë keqpërdorimin e simbolit të akreditimit, por natyra dhe rreziku i gjetjeve të tilla nuk e justifikojnë tërheqjen e akreditimit.
- b. Mos respektimi i afateve të përcaktuara në procedurat e DPA.
- c. Mos zgjidhja e moskonformiteteve në përputhje me procedurat e DPA.
- d. Rezultati negativ i hetimit të një ankese.
- e. Mospagimi i tarifave.

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit</p>	<p>Kodi DA – PT - 006</p>
		<p>Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023</p>
		<p>Faqe 5 nga 18</p>


- f. OVK nuk ka njoftuar DPA sipas kohës së përcaktuar në kontratë për ndryshimet që kanë ndodhur në OVK, gjë që ndikon në përmbushjen e kërkesave të akreditimit.
- g. OVK e akredituar nuk i siguron DPA-së akses tek personeli, dokumentacioni, vendndodhja, pajisjet, informacionet dhe regjistrimet.
- h. OVK e akredituar nuk siguron aksesin tek klienti i tyre për të dëshmuar gjatë kryerjes së aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit në vendndodhjen e klientit.
- i. Mungesa e dokumentacionit të kërkuar për kryerjen e vizitave mbikëqyrëse.
- j. OVK e akredituar nuk respekton programin e akreditimit.
- k. OVK e akredituar nuk ka kryer ndonjë aktivitet të vlerësimit të konformitetit sipas fushës së akreditimit për më shumë se një vit.
- l. OVK e akredituar nuk pranon organizimin e vizitës mbikëqyrëse ose vizitën e jashtëzakonshme.
- m. Nëse OVK e akredituar ofron dhe lëshon certifikime kundrejt standardeve që përdoren si standarde për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit (psh ISO /IEC 17025, ISO 15189)
- n. Nëse organi certifikues i akredituar që ka lëshuar certifikimin nuk bashkëpunon me organin certifikues ku do të transferohet certifikimi ose pezullon pa shkak certifikimin e klientit që kërkon transferimin e certifikimit.

Pwrgjegjwsi i Sektorit për Financat dhe Shërbimet rekomandon pezullimin vetëm kur OVK refuzon të paguajë tarifat (pika 6.3 e).

Periodha e pezullimit të akreditimit nuk duhet të kalojë më shumë se 6 muaj.

6.4 HEQJA E PEZULLIMIN

Kur OVK konsideron se arsyeja (et) e cila rezultoi në pezullimin e akreditimit është zgjidhur, zyrtarisht i komunikon DPA-së gatishmërinë e saj për të rinisur aktivitetin, duke kërkuar heqjen e pezullimit dhe dërgon dokumentacionin/dëshmitë e nevojshme.

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 6 nga 18

Kur akreditimi është pezulluar për arsye financiare (pika 6.3.e), shefi i Sektorit për Financat dhe Shërbimet verifikon pagesën dhe raporton tek Drejtori i Përgjithshëm i cili brenda 15 ditëve merr vendim për heqjen e pezullimit.

Kur akreditimi është pezulluar për arsye teknike (të gjitha rastet e tjera të 6.3, përveç pikes (e), kryevlerësuesi shqyrton të gjithë dokumentacionin /dëshmitë e dorëzuara nga OVK dhe i propozon Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese dhe inspektuese një nga veprimet e mëposhtme:

- vlerësimi i dokumentacionit / regjistrimeve nga grupi i vlerësimit,
- organizimi i një vlerësimi në vend.

Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese shqyrton të gjithë dokumentacionin / dëshmitë dhe propozimin e kryevlerësuesit dhe vendos se cilat veprime do të ndërmerren. Kryevlerësuesi zbaton procedurën DA-PT-001 për të dyja veprimet. Vendimi për heqjen e pezullimit bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm konform procedurës DA-PT-001. Nëse vendimi është pozitiv, dmth hiqet pezullimi, Departamenti i Zhvillimit përditëson listën e organeve të akredituara. Nëse vendimi është negativ, fillon procedura e tërheqjes së akreditimit. Në të dy rastet DPA informon OVK mbi vendimin. Nëse vendimi është negativ, OVK ka të drejtë të paraqesë ankesë sipas procedurës së ankimit (DA-PM-005).



 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 7 nga 18

DIAGRAMA E PEZULLIMIT




7. TËRHEQJA E AKREDITIMIT

Tërheqja e akreditimit nënkupton ndërprerjen e statusit të akreditimit për fushën e plotë të akreditimit. Tërheqja mund të kërkohej nga OVK e akredituar ose nga DPA. Në të dyja rastet, pezullimi vullnetar ose pezullimi i kërkuar nga DPA, zbatohet procedura e mëposhtme.

Në rast të tërheqjes së akreditimit, OVK mund të ri-aplikojë për akreditim vetëm pas 6 muajsh

7.1 TËRHEQJA E AKREDITIMIT E KËRKUAR NGA OVK

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit</p>	<p>Kodi DA – PT - 006</p>
		<p>Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023</p>
		<p>Faqe 8 nga 18</p>

Organi i akredituar paraqet pranë DPA kërkesën me shkrim për tërheqje të akreditimit.


Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese pas shqyrtimit të kërkesës, analizon motivet për të cilat kërkohet tërheqja dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm. Nëse është e nevojshme, drejtori i departamentit të akreditimit mund të kërkojë mendimin e kryevlerësuesit. Kryevlerësuesi shqyrton kërkesën e e OVK dhe bën memo drejtorit të departamentit të akreditimit. Brenda 15 ditëve, Drejtori i Përgjithshëm merr vendim për tërheqjen. DPA informon OVK mbi vendimin dhe kërkon kthimin mbrapsht të certifikatës së akreditimit.

Drejtorja e Zhvillimit përditëson listën e organeve të akredituara në ëbsitin e DPA duke e vendosur OVK në listën e OVK të cilave i është tërhequr statusi i akreditimit. OVK qëndron në këtë listë derisa statusi i akreditimit do të ishte i vlefshëm

7.2 TËRHEQJA E AKREDITIMIT E KËRKUAR NGA DPA

Statusi i akreditimit është tërhequr nga DPA kur një ose më shumë nga kushtet për tërheqje të renditura në pikën 7.3 të kësaj procedure janë plotësuar. Në rastin e pikës 7.3 a) dhe f), Shefi i Sektorit për Financat dhe Shërbimet bën rekomandimin për tërheqje dhe ia dorëzon brenda 10 ditëve, Drejtorit të Përgjithshëm për vendimmarrje. Në të gjitha rastet e tjera të renditura në pikën 7.3, kryevlerësuesi bën rekomandimin për tërheqje dhe ia dorëzon Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese dhe inspektuese me të gjitha dëshmitë. Në rast të organeve të lidhura, Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese paraqet rekomandimin e kryevlerësuesit me të gjitha dëshmitë tek komiteti teknik përkatës.

Pas analizimit të të gjitha evidencave, Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtorit të Akreditimit të organeve certifikuese dhe inspektuese ose komiteti përkatës teknik në rast të organeve të lidhura, brenda 10 ditëve, dorëzon një rekomandim për tërheqje tek Drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm mund të kërkojë më shumë informacion rreth rekomandimit të tërheqjes. Brenda 15 ditësh pas marrjes së të gjitha informacioneve, Drejtori i Përgjithshëm merr vendim për tërheqjen. Ai njofton OVK për vendimin mbi tërheqjen, duke përfshirë një shpjegim të qartë të arsyeve që kanë rezultuar në tërheqje. Nëse vendimi është tërheqja e akreditimit, DPA i kërkon OVK të kthejë mbrapsht certifikatën e akreditimit dhe programin e akreditimit.


 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 9 nga 18

Drejtorja e Zhvillimit përditëson listën e organeve të akredituara në websitin e DPA duke e vendosur OVK në listën e OVK të cilave i është tërhequr statusi i akreditimit. OVK qëndron në këtë listë derisa statusi i akreditimit do të ishte i vlefshëm. Organi ka të drejtë të apelojë brenda 10 diteve pas marrjes së vendimit. Ankesa trajtohet konform procedurës DA-PM-005. Megjithatë, nisja e një ankimimi nuk çon në pezullimin e vendimit të DPA, mbi tërheqjen e akreditimit.

7.3 KUSHTET PËR TËRHEQJEN E AKREDITIMIT

Kushtet mbi të cilat DPA vendos për tërheqjen e akreditimit janë si në vijim:

- a. OVK ose personi juridik ka falimentuar.
- b. OVK nuk arrin të përmbushë kërkesat e akreditimit pas përfundimit të afatit të pezullimit
- c. Kur afati i pezullimit ka përfunduar dhe OVK nuk ka sjellë asnjë informacion për mbylljen e kushteve për pezullim.
- d. Ka gjetje kundër veprimtarisë së OVK të akredituar, duke përfshirë keqpërdorimin e simbolit të akreditimit/certifikatës së akreditimit, të cilat paraqesin rrezik dhe impakt shumë të lartë.
- e. Nëse ka dëshmi objektive të mashtrimit në aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të OVK dhe /ose nëse përcaktohet se OVK lëshon regjistrime/raporte/certifikata falsë
- f. Në qoftë se OVK-ja me dashje keqinformon DPA-në, fsheh qëllimisht informacionin ose dorëzon shënime ose prova të rreme në DPA.
- g. Nëse OVK bën referencë në akreditim në mënyrë të gabuar në kundërshtim me politikën e DPA, DA-PO-005, për skemat të akreditimit apo aktivitete të vlerësimit të konformitetit për të cilat nuk është e akredituar.
- h. Ekzistenca e situatave objektive që pengojnë përmbushjen e marrëveshjes së akreditimit ndërmjet DPA dhe OVK (kontrata)
- i. Afati i fundit për pagesë të përcaktuar në vendimin e pezullimit ka përfunduar.
- j. Mos mbyllja e ankesës kundër OVK.


 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 10 nga 18

- k. Nëse OVK është e përfshirë në deklaratat dhe sjelljet që dëmtojnë prestigjin dhe reputacionin e akreditimit të tij ose DPA-së.
- l. Nëse organi certifikues i akredituar që ka lëshuar certifikimin vazhdon të mosbashkëpunojë me organin certifikues ku do të transferohet certifikimi ose tërheq pa shkak certifikimin e klientit që kërkon transferimin e certifikimit.


7.4 INFORMACION PËR IAF


Në rast të sanksioneve për OVK, akreditimi i të cilëve është tërësisht i tërhequr për shkak të një prej arsyeve të përcaktuara në 7.3 (e), (f), (g), ose pezullohet për shkak të arsyes së përcaktuar në 6.3 (m) dhe është aktive në programet e akreditimit sipas IAF MLA, specialisti i drejtorisë së zhvillimit njofton sekretariatit e IAF-së në fund të periudhës së apelimit; ose pas përfundimit të ankesës. Njoftimi i DPA do të jetë në formatin:

"[DPA] [pezulloi/tërhoqi] [akreditimin e statusit të OVK] në [datën] për shkak të [moskonformitetit të identifikuar]".

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 11 nga 18

7.5 DIAGRAMA PËR TËRHEQJEN E AKREDITIMIT



 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 12 nga 18

8. ZGJERIMI I AKREDITIMIT

Me zgjerim të Akreditimit do të kuptojmë rritjen e numrit të analizave/shërbimeve brenda programit për të cilën tashmë OVK është i akredituar, shtimin e numrit të vendndodhjeve ku kryhet aktiviteti i vlerësimit të konformitetit brenda të njëjtës skemë të akreditimit si dhe kërkesën për akreditim për një aktivitet ose skemë të re të vlerësimit të konformitetit brenda skemës së njëjtë të akreditimit.

OVK që ka statusin e akreditimit fillestar mund të aplikojë për zgjerimin e akreditimit pasi të jetë përfunduar me sukses vizita e parë mbikqyrëse

OVK e akredituar mund të aplikojë për zgjerimin e akreditimit pasi të ketë marrë vendimin për mirëmbajtjen e akreditimit pas çdo vizitë mbikqyrëse


Nëse OVK e akredituar dëshiron që DPA të menaxhojë zgjerimin e akreditimit gjatë vizitës së ardhshme të mirëmbajtjes, duhet të aplikojë për zgjerim jo më vonë se dy muaj para vizitës mbikqyrëse.

Në rast së OVK e akredituar kërkon zgjerim të Akreditimit, atëherë ai duhet të plotësojë formularin përkatës të aplikimit bashkë me dokumentacionin përkatës të cilën e dorëzon në DPA. Pas 10 ditësh nga koha e marrjes së kërkesës për zgjerim Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese i propozon Drejtorit të Përgjithshëm fillimin e procedurës për vlerësimin e zgjerimit. Drejtori i Përgjithshëm merr vendimin mbi fillimin e procedurës.

Kur OVK kërkon zgjerim të akreditimit për fushën ku është e akredituar, me rekomandimin e vlerësuesit teknik, zgjerimi i Akreditimit mund të bëhet edhe në mënyrë administrative. Rekomandimi i vlerësuesit dhe i Drejtorit të Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese ose në rastin e organeve të lidhura rekomandimi i komitetit teknik përkatës i përcillet Drejtorit të Përgjithshëm i cili merr vendimin mbi zgjerimin e Akreditimit.

Kur zgjerimi nuk mund të bëhet në mënyrë administrative ose OVK aplikon për zgjerim në një fushë të re, DPA ndjek procedurën DA-PT-001.

Kur OVK kërkon të ketë vlerësimin për zgjerim para vizitës tjetër të mbikqyrjes, DPA organizon vizitën e vlerësimit. Vlerësimi përfshin vetëm vlerësimin e pjesës teknike.

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit</p>	<p>Kodi DA – PT - 006</p>
		<p>Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023</p>
		<p>Faqe 13 nga 18</p>

Kur OVK aplikon për zgjerimin e akreditimit pas akreditimit fillestar, DPA rishikon programin e vlerësimit dhe planifikon vlerësimin pasues.

9. REDUKTIMI I AKREDITIMIT

Reduktimi i akreditimit do të thotë se DPA anulon një pjesë të programit të akreditimit. Reduktimi i akreditimit mund të kërkohet vullnetarisht nga OVK e akredituar ose kërkohet nga DPA kur një apo më shumë nga kushtet e parashtruara në pikën 9.3 janë plotësuar. Në të dy rastet, zbatohet procedura e mëposhtme.

9.1 REDUKTIMI I AKREDITIMIT I KERKUAR NGA OVK


Reduktimi i Akreditimit mund të kërkohet nga OVK si rezultat i vështirësive financiare, teknike, ose personelit. OVK paraqet kërkesën për reduktimin e akreditimit në DPA. Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese pasi shqyrton kërkesën në bashkëpunim me kryevlerësuesin i propozon Drejtorit të Përgjithshëm reduktimin e programit të akreditimit të OVK. Ky i fundit merr vendimin përfundimtar. Për formulimin e drejtë të programit të reduktuar të akreditimit, DPA kërkon opinionin e vlerësuesit/ekspertit teknik.

Programi i reduktuar i akreditimit i lëshohet OVK. Drejtorja e Zhvillimit publikon fushën e reduktuar të akreditimit në faqen e internetit të DPA.

9.2 REDUKTIMI I AKREDITIMIT I KERKUAR NGA DPA

Programi i akreditimit reduktohet nga DPA kur një nga kushtet e tërheqjes të renditura në pikën 9.3 të kësaj procedure është plotësuar. Kryevlerësuesi, bazuar në mendimin e vlerësuesit/ekspertit teknik, propozon reduktimin e akreditimit dhebashke me evidenca ia dërgon Drejtorit të Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese. Në rast të organeve të lidhura, Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese ia përcjell reduktimin e programit të akreditimit komitetit teknik përkatës.

Pas analizimit të të gjitha evidencave, Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese ose komiteti teknik përkatës në rastet e organeve të lidhura,

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 14 nga 18

brenda 10 ditëve, paraqet një rekomandim për reduktimin e programit të akreditimit tek Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtori i Përgjithshëm mund të kërkojë më shumë informacion rreth rekomandimit të reduktimit. Brenda 15 ditësh duke marrë të gjitha informatat, Drejtori i Përgjithshëm merr vendim për reduktimin. Ai i njofton OVK-së vendimin mbi reduktimin duke përfshirë një shpjegim të qartë të arsyeve që kanë rezultuar në reduktimin e akreditimit.

Drejtoria e Zhvillimit publikon programin e reduktuar të akreditimit në faqen e internetit të DPA.


Organi ka të drejte të apelojë brenda 10 diteve pas marrjes së vendimit.

Apelimi trajtohet konform procedurës DA-PM-005. Megjithatë, nisja e një apelimi nuk çon në pezullimin e vendimit të DPA, mbi reduktimin e akreditimit.


9.3 KUSHTET PËR REDUKTIMIN E AKREDITIMIT


Kushtet mbi të cilat DPA vendos për reduktimin e programit të akreditimit janë si në vijim

- a. OVK nuk arrin të përmbushë kërkesa teknike për akreditim.
- b. OVK nuk ka ndërmarrë veprime korrigjuese efektive për moskonformitetet që kanë të bëjnë me çështjet teknike të gjetura gjatë vizitës mbikëqyrese.
- c. Ka ndryshime të dukshme në kushtet operative të OVK lidhur me çështjet teknike të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në përputhjen me kërkesat e akreditimit.

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjërimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 15 nga 18


9.4 DIAGRAMA



 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 16 nga 18

10. RREGJISTRIME QË DALIN NGA KJO PROCEDURË

Titulli i dokumentit	Kush e plotëson	Kur e plotëson	Kush e ruan
Lista e OVK, të akredituara	Sekretariati	Kur pezullohet, tërhiqet ose zgjerohet ose reduktohet akreditimi	Drejtoria e Zhvillimit
Data base për organizmat vlerësimit të konformitetit	Specialisti i Drejtorisë së Zhvillimit	Kur pezullohet, tërhiqet ose zgjerohet ose reduktohet akreditimi	Drejtoria e Zhvillimit
Forma e raportimit të vlerësimit për laboratorët	Grupi vlerësues	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e paraqitjes së moskonformiteteve	Grupi vlerësues	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e njoftimit të datës vlerësimit dhe miratimi i	Specialisti i sektorit	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e planit të vlerësimit	Specialisti i sektorit	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e vlerësimit të procedurave teknike	Vlerësuesi teknik	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e paraqitjes së veprimeve korigjuese	Grupi vlerësues	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e njoftimit të emërimit të grupit dhe aprovimit të tij	Specialisti i sektorit	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e raportit të vlerësimit të organizmave të certifikimit të personelit	Grupi vlerësues	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e raportimit tek Drejtoria e Përgjithshme	Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues/mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e regjistrimit të apelimeve dhe ankesave	Menaxheri i Cilësisë	Kur pezullohet dhe tërhiqet akreditimi	Menaxheri i Cilësisë
Forma për vendimin për akreditim	Drejtori i Përgjithshëm	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Kontratë tip me vlerësues	Sektori i financës	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Kontratë tip me organizmat e vlerësimit të konformitetit	Drejtori i Drejtorisë të Akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues/mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi për akreditim	Sekretariati

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Proçedura e pezullimit, tërheqjes, reduktimit dhe zgjerimit të akreditimit	Kodi DA – PT - 006
		Rishikim nr. 8 Dt: 05.10.2023
		Faqe 17 nga 18

	Akreditimit të organeve certifikuese ose inspektuese		
Forma e raportit të vlerës organizmave të certifikimit të produkteve	Grupi vlerësues	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e raportit të vlerës organizmave të certifikimit të sistemeve të menaxhimit	Grupi vlerësues	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati
Forma e raportit të vlerës organizmave të inspektimit	Grupi vlerësues	Kur zgjerohet dhe reduktohet akreditimi	Sekretariati

11. HISTORIKU

Data e ripunimit	Numri i rishikimit	Hartoi	Përshkrimi i ndryshimeve
30.10.2006	0	Briseida Xhafa	Varianti fillestar
30.10.2008	1	Briseida Xhafa	Miratimi i proçedurës në përputhje me ligjin nr. 9824 datë 1.11.2007 dhe paragrafi nr. 8 në lidhje me zgjerimin
23.10.2009	2	Ermira Fyshku & Besnik Pani	Paragrafi 6.1.4 në lidhje me pagesën në rast vetëpezullimi. Paragrafi 6.3.5 Pezullimi ose reduktimi i akreditimit të një organizmi me shumë vendndodhje.
21.07.2011	3	Ardita Fuga	Në paragrafin 6.3.1 dhe 6.3.2 në lidhje me kushtet e pezullimit të akreditimit nga DPA; Në 6.4.3 në lidhje me rifillimin e aktivitetit pas pezullimit; Në paragrafin 8 në lidhje me afatet e paraqitjes së dokumentacionit për zgjerimin e akreditimit. Në paragrafin 9 pasqyrimi i përditësimeve sipas DA-PT-014.
22.12.2014	4	Briseida.XHAFa	Janë bërë ndryshime tek koka e dokumentit në lidhje me numrat e telefonit dhe adresën e emailit të DPA. Në faqen e parë gjithashtu është ndryshuar emri i Ministrisë. Në paragrafin 4 është ndryshuar numri i Ligjit si dhe i VKM.



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

**Proçedura e pezullimit,
tërheqjes, reduktimit dhe
zgjerimit të akreditimit**

Kodi DA – PT - 006

Rishikim nr. 8
Dt: 05.10.2023

Faqe 18 nga 18

20.05.2019	5	Vilma Mara	Rishikuar sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17011 :2017
31.03.2021	6	Ardita Mele	Ne pikat 6.1 ; 6.2 ; 7.1 ; 7.2 është shtuar mënyra e paraqitjes së OVK në ëbsitin e DPA kur i është pezulluar apo tërhequr statusi i akreditimit
26.04.2021	7	Ardita Mele	Rishikimi i procedurës bazuar në strukturën e re të DPA dhe është shtuar pika 6.3 (n) bazuar në IAF MD 2 pika. 2.4.4.
05.10.2023	8	Ardita Mele	Rishikimi i paragrafit 8 të procedurës në lidhje me zgjerimin e akreditimit dhe mënyrës së njoftimit të IAF